



## **Raport mbi veprimtarinë vjetore të investimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme gjatë vitit 2022.**

Referuar ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë, nenit 18, pika 1, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.56, datë 03.10.2017 për miratimin e rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij” dhe dokumentit “Politika e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, veprimtaria vjetore investuese për portofolin e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për periudhën Janar - Dhjetor 2022 dhe gjendja e tij në fund të vitit 2022 paraqitet si vijon:

Në dhjetor të vitit 2021, Komiteti i Investimeve në zbatim të Politikës së Administrimit të Mjeteve Financiare, miratoi strategjinë vjetore të investimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2022. Kjo strategji është përditësuar më tej dy herë gjatë vitit. Gjatë 2022 nuk ka pasur ndryshim të Politikës së Investimeve për FNJ. Politika e investimit vijon të ndjekë parimet e likuiditetit të lartë, rrezikut të ulët të kredisë dhe normës së lartë kthimit pas respektimit të dy parimeve të para.

Në vijim të njoftimit të Bankës së Shqipërisë për kontributin e vitit të pestë, të gjitha bankat bënë pagesën përkatëse të kontributit për këtë vit, në shumën prej 734 598 664 lekë, brenda afatit të pagesës, datë 30 prill 2022.

Mjetet financiare në dispozicion të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në fund të vitit 2022, arrijnë vlerën prej 3 526 milion lekë, duke shënuar një rritje prej 29.8% krahasuar me një vit më parë.


Arkëtimi i kontributit të vitit të pestë u krye në një periudhë kohore një mujore (28.03 – 28.04.2022). Me qëllim mbajtjen e një portofoli investimesh të diversifikuar në maturitete, Agjencia e ka shtrirë investimin e mjeteve të fondit (së bashku me kontributin e paguar) gjatë gjithë vitit. Për të mundur këtë, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është investuar në depozitë një javore pranë Bankës së Shqipërisë. Ky instrument i përdorur gjatë gjithë vitit, ka kontribuar në ruajtjen e transhit të likuiditetit duke siguruar





në të njëjtën kohë të ardhura nga interesi. Niveli mesatar mujor i depozitës gjatë vitit ka qenë 243,4 milionë lekë ose sa e 6.9% e fondit në fund të vitit 2022.

Në prill 2022, Komiteti i Investimeve në përputhje dhe në zbatim të politikës së administrimit të mjeteve financiare të fondit, me qëllim ruajtjen e raporteve të transheve sipas monedhës, vendosi që të konvertojë gjatë periudhës së arkëtimit të kontributit vjetor, kundërvlerën e 700 000 eurove. Portofoli në valutë, në fund të vitit, arriti vlerën prej 2.05 milion euro, që përbën rreth 6,7% të totalit, duke respektuar kufirin e vendosur në politikën e administrimit të mjeteve financiare të FNJ, prej minimalisht 5% të portofolit. Nga ky portofol, 2 000 000 euro kanë qenë të investuara në obligacionin 2 vjeçar të emetuar nga Qeveria Shqiptare, ndërsa shuma prej 48 360 euro është mbajtur në llogari pranë Bankës së Shqipërisë. Nënportofoli në valutë është i investuar vetëm në monedhën euro dhe përfshin investime të bëra vetëm në tituj të Qeverisë Shqiptare, të emetuara në euro në tregun e brendshëm.



Nënportofoli në lekë në fund të vitit 2022 është në vlerën 3 278 milion lekë dhe ka një peshe prej 93,3% kundrejt të gjithë vlerës së Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Investimet në monedhën vendase janë bërë duke pasur parasysh shpërndarjen sipas maturiteteve në një larmi datash maturimi me qëllim evitimin e përqendrimeve të larta në data të caktuara.

Gjatë vitit 2022 është investuar në tituj përkatësisht në muajt shkurt, prill, maj, qershor, korrik, gusht, tetor dhe nëntor. Përsa i përket afateve të maturimit, gjatë vitit është






investuar në tituj me afat maturimi dy, shtatë dhe dhjetë vjeçar, si dhe bono thesari me maturim 3 mujor.

Përkatësisht në muajt shkurt, maj, qershor, gusht dhe nëntor janë investuar në bono thesari me maturim 3 mujor shumat prej 180 milion lekë, 300 milion lekë, 100 milion lekë, 360 milion lekë dhe 394.9 milion lekë. Në muajt prill, korrik dhe gusht janë investuar në obligacione dyvjeçare respektivisht 500, 195.8 dhe 304.2 milion lekë. Në muajin qershor është investuar në obligacion 7-vjeçar shuma prej 100 milion lekë. Ndërsa në muajin tetor është investuar në obligacion me maturim dhjetë vjeçar shuma prej 130 milion lekë.

Të gjitha investimet e këtij fondi në nënportofolin në lekë janë në tituj të Qeverisë Shqiptare dhe janë kryer në tregun primar.

Gjendja e depozitës në fund të vitit 2022 është në vlerën 2.73 milion lekë. Vlera e likuiditetit të mbajtur në depozitë në tremujorin e fundit të vitit është minimale pasi është investuar më shumë në tituj, duke garantuar kthim më të lart investimi.


Në grafikët në vijim paraqitet ndarja e mjeteve financiare të Fondit në fund të vitit 2022 sipas instrumenteve.



Përgjatë të gjithë vitit, Agjencia është kujdesur jo vetëm për një administrim sa më efektiv të fondit, por edhe duke mbajtur në vëmendje ruajtjen e raporteve sipas transeve dhe monedhës, të përcaktuara në politikën dhe strategjinë e investimit. Vihet re, se gjatë



administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në fund të vitit 2022, në transhin e likuiditetit ka një rënie të mbajtjes së likuiditetit në depozitë dhe në llogari rrjedhëse, krahasuar me fillimin e vitit, ndërkaq vërehet rritje e investimeve kryesisht në obligacione të emetuara nga qeveria shqiptare.



Transhi i likuiditetit në fund të vitit ka vlerën 453,2 milion lekë dhe ka pësuar ulje me 59% në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2022 pasi ka një ulje të shumës së mbajtur në depozitë në Bankën e Shqipërisë, në llogari rrjedhëse dhe rritje të shumës së investuar në tituj me maturitet të mbetur mbi tre muaj.

Transhi i investimit në fund të vitit ka vlerën 3 058,46 milion lekë dhe ka pësuar një rritje prej 70% krahasuar me tremujorin e parë të vitit, pasi janë rritur ndjeshëm si investimet me maturitet të mbetur deri në 2 vjet, ashtu edhe investimet me maturitet të mbetur mbi 2 vjet.

Performanca e arritur nga administrimi i këtij fondi është e kënaqshme, ku norma vjetore e kthimit për portofolin e investuar të FNJ në mbyllje të vitit financiar 2022 është rreth 2,62%.